



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 215, Datë 24.08.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SMART TRADE AND CONSULTING” SH.P.K., PËR  
RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1476/1 prot., datë 19.08.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/1 prot., datë 09.08.2022, ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.
- Në zbatim të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovim jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Aplikimi i shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
  - Dokumentacioni juridik dhe administrativ - neni 9, pika 2, gërmat “c”, “d” dhe “e”..
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “b” dhe “d”..
  - Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike –neni 9, pika 4.8, gërma “c”.
- Shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k. në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, duhet të depozitojë në ERE dokumentacion/informacion në lidhje me nenin 9, pika 2, gërma “a” dhe “b”, nenin 9, pika 3 gërma “a” dhe “c” si dhe nenin 9, pika 4.8, gërma “a” dhe “b”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**